




**Republika e Shqipërisë**  
**Dhoma e Noterëve Vlorë**  
**Zyra Notoriale Fier**  
**Notere Vojsava F.BETA**  
**Nipt nr. L32903402I**  
**Nr.licence 121.**



Fier më 16.12.2017  
Nr. **2302** Repertori  
Nr. **1157** Koleksioni  
*(Signature)*

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"NESIA" Shpk.**

Në Fier, sot me date **16.12.2017**, perpara meje **VOJSAVA FAIK BETA** (*dymije e shtatëdhjete*), ne zyren time, perpara meje noteres VOJSAVA FAIK BETA, me studio ligjore me qender ne FIER, prane Gjykates se Faktit, u paraqiten shtetasi i Huaj me identitetin si meposhte:

-**Esmralda Calamante**, me atësi Attilio dhe me amësi Maria, e datelindjes 14.09.1962, lindur në Itali dhe rezidente në -Shqiperi, madhore e me zotesi te plete per te vepruar pa pengesa ligjore, e panjohur prej meje noteres por per identitetin e te cilës u sigurova me anen e dokumentit italian pasaporte me nr. **YA2754526**,

*në cilësine e përkthyesit ligjor:*

**Arbana Zarka** me atësi Lazar dhe me amësi Kleopatra, e datelindjes 20.09.1969, lindur në Fier dhe banuese në Fier, madhore e me zotesi te plete per te vepruar pa pengesa ligjore, e panjohur prej meje noteres por per identitetin e te cilës u sigurova me anen e dokumentit leternoftim ID me nr. **G95920083C**.

e cila me cilësine e "ortakut themelues", me vullnet të lire të plete e të sinqerte, mbeshtetur ne inisiativen e lire private, Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", me kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi te shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar, "NESIA" Shpk.

KREU I

Neni 1  
Krijimi



  
Shoqeria "NESIA" Shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqeria").

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria "NESIA" Shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaku i vetem", i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbalon humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3  
Selia

*Shoqeria e ka seline në lagjia "Nr. 1" Roskovec, Fier, me nr.pasurie 2/367, ZK3196 me sip. 328 m2. dhe me nr.pasurie 2/366, ZK3196 me sip. 328 m2.*

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4  
Objekti i veprimitarise së shoqërisë

Objekti Veprimitarise është si më poshtë:

Fabrike kepucesh, Prerje e qepje (orlature) me montim të pjeseve te ndryshme te kepuceve, sandaleve, çizme, shapka, atlete per te gjitha stinet, modelim, berje kampionesh, punime me dore, lyerje, vodosje aksesoresh, etiketim, ambalazhim, modelim, kontroll, tregimi dhe ekspotyimi i tyre.

Import eksport me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industrial.

Ky aktivitet do te ushtronhet pas marrjes se Liçences përkatese.


Neni 5  
Kohezgjatja


Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II  
KAPITALI

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 50.000 lekë (pesedhjetemije) leke te reja .





Esmeralda Calamante - zoterues i 1(një) kuote të vetme , prej 50.000 lekë (pesedhjetemije) leke te reja leke, vlere te per gjithshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II  
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8  
Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen së to është. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9  
Administrimi

Administrimi

Administrator të shoqerise vendosen dy:

1- Administrator i pare i shoqerise eshte zj. **Jonida Meçanaj**.

2-- Administrator i dyte i shoqerise eshte zj. **Esméralda Calamante**

Administratorët e shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per një afat 2(dy) vjeçare me te drejtë riperteritje.

Administratorët emerohen dhe shkarkohen me vendim te Ortakut te Vetem të shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person i trete jashtë ortakerise.

Neni 10  
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem,


b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhënet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11  
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykates;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13  
Baza Ligjore

dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemlare ne gjuhen shqipe, dhe Italiane me permbajtje dhe vlera te njejtave juridike.

Autorizohet Adm. Jonida Meçanaj te depozitoje aktet per regjistrim prane QKR.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare Shoqëria "NESIA" Shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të ciles vertetohet nga une Noterja.

ORTAKU I VETEM

*Përkthyes Ligjor*

Esmeralda Calamante

ESMERALDA CALAMANTE



*Arbana Zarka*



**NOTERE**

**VOJSAVA FAIK BETA**

